VENDIM
Nr.596, datë 7.9.2006

PËR PËRDORIMIN, RUAJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E DOKUMENTEVE TË IDENTITETIT TË SHTETASVE NGA ORGANET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 19 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Identifikimi i shtetasve shqiptarë, aplikues për të përfituar shërbime apo për të marrë pjesë në procedurat, që zhvillohen nga organet e administratës publike, bëhet nëpërmjet paraqitjes nga shtetasi në organin administrativ, të njërit prej dokumenteve si më poshtë vijon:

a) certifikatë lindje me fotografi të lëshuar, sipas ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", të ndryshuar;

b) "letërnjoftim", të lëshuar sipas ligjit nr.5840, datë 20.2.1979 "Për regjistrimin e akteve të gjendjes civile", në të gjithë rastet kur përdorimi i tyre lejohet me ligj;

c) pasaportë për jashtë shtetit, e lëshuar sipas ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar, ku bëjnë pjesë:

i.pasaporta e zakonshme;

ii. pasaporta e shërbimit;

iii. pasaporta diplomatike.

2. Administrata publike, në të gjitha rastet kur procedurat në fuqi parashikojnë mbajtjen e dokumenteve të identifikimit të shtetasit në dosje, për nevoja të përcaktimit të identitetit të tij, është e detyruar që të bëjë me mjetet e veta, fotokopjimin e dokumentit të identifikimit dhe njësimin e tij me origjinalin.

3. Në të gjitha rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, nëpunësi ose punonjësi i administratës publike, verifikon me sy elementet e sigurisë së dokumentit dhe kryen fotokopjimin e dokumentit, kur e gjen atë të rregullt. Ai vendos në kopje shënimin me shkrim: "E njëjtë me origjinalin, që paraqiti (emër, mbiemër)" dhe plotëson me shkrim dore: emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

Mungesa në kopje e shënimit "E njëjtë me origjinalin...", apo/dhe mungesa e pjesshme apo e plotë e njërit prej elementeve emër, mbiemër, nënshkrimi i nëpunësit ose punonjësit të administratës publike, ngarkon me përgjegjësi administrative dhe disiplinore, në varësi të çastit të konstatimit, nëpunësin dhe/ose punonjësin, që ka kryer pranimin e aplikimit apo personin që e ka përpunuar atë.

4. Njësimi me origjinalin i dokumenteve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, kryhet pa pagesë, drejtpërdrejt nga nëpunësi që ka përgjegjësi funksionale ose të deleguar, për mbledhjen dhe administrimin e kërkesave për regjistrime, shërbime, leje, licenca, përfitime pagesash ekonomike etj., në institucionin e administratës, që ofron shërbimin, apo në degën e saj.

5. Dokumenti i njësuar bashkëlidhet me dokumentacionin tjetër të praktikës dhe ruhet e administrohet në dosje, në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", të ndryshuar.

6. Për efekt të këtij vendimi, certifikata e lindjes me fotografi, e lëshuar nga zyra e gjendjes civile ose shërbimi konsullor, në mbështetje të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, nuk ka kohëzgjatje vlefshmërie, për efekt identifikimi të shtetasve shqiptarë.

7. Ndalohet perdorimi si dokument identifikimi i akteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, përmbajtja apo forma e të cilave ka dalë nga përdorimi. Në elementet e përmbajtjes përfshihet edhe afati i përdorimit të dokumentit.

8. Përjashtim nga pika 2 e këtij vendimi, bëjnë organi i prokurorisë dhe gjykatat, ku për identifikimin e shtetasve shqiptarë dhe për ruajtjen e administrimin e këtij identiteti, zbatohen rregulla të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

9. Ky vendim nuk i shtrin efektet e veta edhe ndaj procedurës, që kryen Policia e Shtetit, për përgatitjen e pasaportave për jashtë shtetit, sipas ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar.

10. Ky vendim zbatohet me përparësi ndaj akteve të tjera të Këshillit të Ministrave, urdhërave, udhëzimeve dhe rregulloreve të ministrave, drejtuesve të institucioneve, qendrore a të varësisë dhe të organeve të pavarura, të cilat parashikojnë depozimin e dokumenteve të parashikuara në pikën 1 të këtij

vendimi, për nevoja të identifikimit të shtetasve.

11. Ngarkohen të gjitha institucionet e administratës publike të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha